


02-1713



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 97 të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dt. 25.05.2016 21, nenit 21, pika 4, të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, nenit 17 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 15 pika d, e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, nenit 13 pika 4.3 të UA nr. 06/2017 Për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrenimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur në bazë të kërkesës me 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023, në emër të aplikuesve Rashit Bekteshi, Lulzim Gashi, Elmi Cakolli, Agron Baxhaku, Hekri Buzoku, Flamur Saiti, me investitor “Bau Invest Co. LLC, me adresë rr. Antigona Fazliu” nr. 130, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “A23”, të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 07.12.2023 merr këtë:

V E N D I M **PËR REFUZIMIN E KËRKESËS**

REFUZOHET kërkesa 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023, në emër të aplikuesve Rashit Bekteshi, Lulzim Gashi, Elmi Cakolli, Agron Baxhaku, Hekri Buzoku, Flamur Saiti, me investitor “Bau Invest Co. LLC, me seli në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “A23”, të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër”, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1052-2, 1052-3, 1052-4, 1052-1, 1052-5 dhe 1052-6 ZK Matičan.

A r s y e t i m

Aplikuesit Rashit Bekteshi, Lulzim Gashi, Elmi Cakolli, Agron Baxhaku, Hekri Buzoku, Flamur Saiti, me investitor “Bau Invest Co. LLC, me seli në Prishtinë, me kërkesën 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në lokacionin e përshkruar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023, aplikuesit kanë prezentuar këtë dokumentacion:

- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatat e njërive kadastrale dhe kopjet e planit për parcelat kadastrale nr. 1052-2, 1052-3, 1052-4, 1052-1, 1052-5 dhe 1052-6 ZK Matičan, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit;
- Informimin nga DPSZHQ, me referencë 04 Nr. 350/01-18490/23 dt. 25.01.2023, të datës 15.02.2023,
- Akti noterial “Kontratë për investim të përbashkët” LRP. Nr. 0744/2023 Ref. Nr. 0203/2023, i datës 09.02.2023, e lidhur në mes të pronarit të tokës Elmir Cakolli dhe investitorit “Bau Invest Co. LLC, me seli në Prishtinë;

- Akti noterial "Kontratë për investim të përbashkët" LRP. Nr. 0017/2023 Ref. Nr. 0005/2023, i datës 10.01.2023, e lidhur në mes të pronareve të tokës Hekri Buzoku, Agron Baxhuku, Rashit Bekteshi dhe investitorit "Bau Invest Co. LLC, me seli në Prishtinë;
- Projektpropozimin e punuar nga "Land Studio", sh.p.k. me numër të biznesit 810196156;
- Manuali "Paraqitja e gjendjes faktike me matje gjeodezike", punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Consulting" sh.p.k., me numër të licencës 65;
- Kopjet e dokumenteve të identifikimit të pronareve;

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, të rregullativës ligjore nga lëmia e ndërtimit, planifikimit dhe procedurës administrative, përmes shkresës zyrtare "Kërkesë për plotësim dokumentacioni" 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023, të datës 31.10.2023, ka kërkuar dhe konstatuar se për vazhdimin e procedurës dhe vendosjen e drejtë të çështjes, që kërkesën ta plotësojnë sipas pikave të përshkruara në shkresë.

Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në konstatimet e lartcekura dhe në rregullativën ligjore, dhe bazuar në nenin 21 pika 4 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, ka kërkuar nga aplikuesit që dokumentacionin e harmonizuar dhe të plotësuar, ta prezantojë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të shkresës, e cila shkresë është tërheq nga aplikuesit me datë 07.11.2023. Pasi që aplikuesi nuk i është përmbajtur afatit ligjor të caktuar për plotësim të dokumentacionit të kërkuar, kjo drejtori konstatoi se nuk mund të vazhdohet me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore për parcelën kadastrale të shënuar më lartë, andaj vendosi që kërkesën ta refuzojë. Bazuar në të dhënat e përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror MMPHI-ja.

Ky Vendim u përpilua në pesë (5) kopje identike, dhe i dorëzohet: Kërkuarit, kësaj Drejtorie, në dosjen e lëndës 05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 19.10.2023 dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-208361/23 dt. 07.12.2023**

Zyrtari,
Mimoza Berisha Prestreshi



Udhëheqëse e Sektorit

